



08 -02- 2020

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 120-2020

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 23 të Rregullores së Punës së KQZ-së, si dhe duke u bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës të datës 07.02.2020, Nr.108/2020, për shpalljen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 08.02.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e SKQZ-së

- I. Miratohet zgjatja e orarit për ditët e punës, për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e Sekretariatit të KQZ-së, duke filluar nga ora 08:00 deri në ora 18:00.
- II. Orari i punës për ditën e shtune dhe të diele do të jetë nga ora 10:00 deri në ora 16:00.
- III. Përveç obligimeve nga pika I dhe II e këtij vendimi, stafi i SKQZ-së obligohet të jetë prezent në punë, gjatë mbledhjeve të KQZ-së, Këshillave dhe aktiviteteve tjera.
- IV. Obligohen departamentet/divizionet që përveç pikës I dhe II të këtij vendimi, bazuar në afatet e ngjeshura dhe ditën e zgjedhjeve, të jenë prezent në vendin e punës, deri në përfundimin e aktiviteteve të parapara me Planin Operacional të Zgjedhjeve
- V. Obligohet personeli i KQZ/SKQZ-së që ditën e zgjedhjeve të datës 15 mars 2020, të jenë prezent në vendin e punës deri në përfundimin e aktiviteteve të parapara me Planin Operacional të ditës së zgjedhjeve.
- VI. Drejtorët e Departamenteve janë përgjegjës për trajtim të barabartë të të gjithë zyrtarëve.
- VII. Drejtorët, sipas vlerësimit të tyre janë përgjegjës të organizojnë praninë e stafit me qëllim të përmbushjes të të gjitha obligimeve, pa marrë parasysh kohën e angazhimit.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me datën 08.02.2020 .

Arsyetim

Duke u bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 07.02.2020, Nr.108/2020 për shpalljen e zgjedhjeve jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës, zgjatja e orarit të punës bëhet për shkak të rritjes së aktiviteteve, afateve të shkurtuara, si dhe angazhimeve për përmbushjen e Planit Operacional, lidhur me përgatitjet dhe administrimin e zgjedhjeve, që do mbahen më 15 mars 2020. Andaj, u vendos si në pikat e dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 08.02.2020

Ky vendim i dorëzohet:
Anëtarëve të KQZ-së
Zyrtareve të SKQZ
Arkivit

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Valdete Daka, Kryetare

